



UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (në tekstin e mëtutjeshëm: “ZRRUK”),

Në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 8.4 të Ligjit No. 03/L-086, Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 qershor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm: “Ligji”),

Pas konsultimeve me Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që janë zhvilluar gjatë procesit të aprovimit të Buxhetit të ZRRUK për vitin 2013,

Me qëllim të përcaktimit të lartësisë së taksës së licencimit ose metodës së kalkulimit të kësaj takse që është e pagueshme sipas nenit 8 të Ligjit,

Me këtë nxjerrë Udhëzimin Administrativ si vijon:

Neni 1

Përkufizimet

1.1 Në këtë Udhëzim Administrativ:

“Ofrues i Shërbimeve” Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit ose Furnizuesit e Ujit me Shumicë, krejt së bashku Ofrues të Shërbimeve, dhe në rast të bashkimit (shkrirjes) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve me një ose më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësin e tij.

1.2 Përveq nëse ndryshe është përkufizuar me këtë Udhëzim Administrativ, fjalët që fillojnë me shkronjë të madhe do ta kenë kuptimin e që iu është dhënë në Ligj.

Neni 2

Taksa e Aplikimit

2.1 Taksa e aplikimit për Licencë të Shërbimit e pagueshme nga një Ofrues i Shërbimeve sipas nenit 8.1 të Ligjit do të jetë €200.00.

Neni 3

Taksa Vjetore e Licencimit

3.1 Taksa vjetore e licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2013 e pagueshme nga një Ofrues i Shërbimeve në pajtim me Nenin 8.2 të Ligjit do të jetë 1.32 % të qarkullimit vjetor bruto të

atij Ofruesi të Shërbimeve e që është vlera e dhënë në Shtojcën 3, e llogaritur në pajtim me Nenin 8.2 dhe 8.3 të Ligjit si vijon:

$$\mathbf{X = B \times t / T}$$

Ku:

X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pagueshme nga secili Ofrues i Shërbimeve

B = Shpenzimet e parapara të ZRRUK për vitin 2013 (shih Shtojcën 1)

t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin paraparak (shih Shtojcën 2)

T = Shuma e qarkullimit vjetor të të gjithë Ofruesve të Licencuar të Shërbimeve në vitin paraparak (shih Shtojcën 3)

- 3.2 Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksën vjetore të licencimit që është e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve që është bashkuar (shkrirë).

Neni 4
Hyria në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi më 10 janar 2013.



.....
Raif Preteni
Drejtore
Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Bashkangjitur:

Shtojca 1: Shpenzimet e Parapara të ZRRUK në 2013

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në 2011 dhe

Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për Ofruesit e Shërbimeve për 2013

Shtojca 1.3: Shpenzimet Totale të ZRRUK të Parashikuara për vitin 2013

SHPENZIMET TOTALE TË ZRRUM NË 2012	
1. Shpenzimet e Personelit	164,450.00
2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve	156,519.00
3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike	7,650.00
Gjithësejt Shpenzimet e ZRRUM-it:	328,619.00

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në vitin 2011 të audituar nga ZRRUK si dhe Taksa vjetore e Licencimit për vitin 2013

SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË			TAKSA VJETORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE 2013		
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)	Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Lartësia e taksës vjetore
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA"	Prishtina	11,432,096	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA"	Prishtine	150,903.67
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	1,131,726.00	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	14,938.78
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI"	Gjakovë	2,662,617.00	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI"	Gjakove	35,164.54
Ofruesi i Ujit me shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtinë	323,244.00	Ofruesi i Ujit me shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtine	4,266.82
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL"	Mitrovicë	2,069,038.00	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL"	Mitrovice	27,311.30
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI"	Pejë	2,709,359.00	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI"	Peje	35,763.54
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI"	Prizren	3,298,167.00	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI"	Prizren	43,535.80
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA"	Gjilan	1,415,161.00	Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA"	Gjilan	18,660.13
Totali – Ofruesit e Ujit dhe Ujërave të Zeza		25,071,566	Total taksa vjetore 2013		330,546.59